




Parandalimi i kufizimeve
për

Organizatat e
Shoqërisë Civile

në emër të Luftës Kundër

Pastrimit të Parave



Financimit të
Terrorizmit

Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF)

Për të adresuar shqetësimin në nivel global mbi pastrimin e parave (PP), financimin e terrorizmit (FT) dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, u krijua **Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF)**, një organ i pavarur ndërqeveritar që harton standardet ndërkombëtare, përcakton metodologjinë e vlerësimit, promovon dhe monitoron efektivitetin e masave të marra nga shtetet, si dhe përputhshmërinë e tyre me standartet.

Rekomandimet e FATF & masat që duhet të marrin shtetet

40 Rekomandimet ‘standartet’ e FATF përcaktojnë një kuadër gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të masave që vendet duhet të zbatojnë në mënyrë që të identifikojnë rreziqet dhe të zhvillojnë politika e koordinim në nivel vendi; të ndjekin pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë; të zbatojnë masa parandaluese për sektorin financiar dhe sektorë të tjerë; të përcaktojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse; e të mbështesin bashkëpunimin ndërkombëtar.

Rekomandim 8 i FATF për Organizatat Jofitimprurëse

Subjekt i Rekomandimit 8 të FATF janë “**Organizatat që angazhohen kryesisht në mbledhjen ose disbursimin e fondeve për qëllime bamirësie, fetare, kulturore, arsimore, sociale apo vëllazërore, ose për kryerjen e qëllimeve të tjera për punë të mira**”.

Rekomandimi 8 u kërkon vendeve që të identifikojnë, vlerësojnë dhe kuptojnë rreziqet lidhur me abuzimin apo keqpërdorimin e OJF-ve për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, bazuar në Vlerësimin e Riskut për OJF-të.

Qeveritë në nivel kombëtar dhe në bashkëpunim me OJF-të duhet të marrin një sërë masash të fokusuara, të cilat nuk duhet të pengojnë aktivitetin e ligjshëm të OJF-ve, të identifikojnë OJF-të e shfrytëzuara dhe të veprojnë në mënyrë efikase dhe proporcionale kundrejt tyre.

”

Në Shqipëri të gjitha OJF-të klasifikohen me nivel të lartë risku kundrejt pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, prandaj nevojitet të kryhet **Vlerësimi i Riskut për OJF-të** sipas kriterëve ndërkombëtare të përcaktuara nga FATF!

”

Vlerësimi i Ndërsjelltë i Rekomandimeve të FATF

Niveli i zbatimit të Rekomandimeve të FATF vlerësohet përmes proceseve të Vlerësimit të Ndërsjelltë (Mutual Evaluation), ku anëtarë nga vende të ndryshme vlerësojnë një vend tjetër.

Metodologjia e vlerësimit përfshin dy komponentë të ndërlidhur:



Vlerësimi teknik i pajtueshmërisë, i cili lidhet me kornizën ligjore dhe institucionale të vendit, pushtetin dhe procedurat e autoriteteve kompetente.



Vlerësimi i efektivitetit, i cili adreson se në ç'masë një vend ka arritur të përmbushë rezultatet që janë të rëndësishme për një sistem të shëndetshëm të parandalimit të pastrimit të parave dhe luftës kundër terrorizmit.

Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të FATF në Shqipëri

Në Shqipëri, të gjitha masat e ndërmarra në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit monitorohen nga Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit – MONEYVAL, një organ i përhershëm i Këshillit të Evropës, i cili vlerëson pajtueshmërinë e masave me standardet ndërkombëtare të FATF dhe jep rekomandime për përmirësimet e nevojshme.

” Në Raportin e Pestë të Vlerësimit të Përbashkët të MONEYVAL (2018), Rekomandimi 8 vlerësohet: Pjesërisht në Përputhje.



Institutionet kryesore përgjegjëse në Shqipëri për zbatimin e Rekomandimit 8

1 Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave

Ka për mision mbrojtjen e interesave të vendit nga krimi financiar dhe financimi i terrorizmit dhe të kontribuojë në stabilitetin, integritetin, rritjen dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar në Shqipëri dhe të ekonomisë në përgjithësi, nëpërmjet zbulimit dhe goditjes së veprimtarive kriminale me anë të programeve rregulatore dhe të inteligjencës financiare.

2 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Organet tatimore janë organe mbikqyrëse për kontrollin e veprimtarisë së OJF-ve, me qëllim shmangien e mundësisë së përdorimit të tyre për pastrim parash apo financim të terrorizmit.

Këto institucione bashkëpunojnë me njëra – tjetrën, si më poshtë:

1 Shkëmbejnë të dhëna në lidhje me:

- a) gjetjet nga kontrollet tatimore për OJF-të;
- b) të dhëna për OJF-të që kryejnë transaksione të dyshimta;
- c) evidentimin e rreziqeve në fushën tatimore dhe atyre të PP/FT.


2 Përditësojnë tipologjitë e OJF-ve të dyshimta si vijon:

- a) nga gjetjet dhe investigimet e përbashkëta;
- b) bazuar në shkeljet e indikatorëve të riskut;
- c) nga kontrollet e përbashkëta;
- ç) nga manuale/rregullore të ndryshme kombëtare/ndërkombëtare, të cilat janë të miratuara nga institucione të specializuara në fushën e PP/FT.

3 Evidentojnë OJF-të me risk bazuar në shkëmbimet e informacioneve të vijueshme midis tyre.

4 Nxjerrin rregullore të përbashkët për evidentimin dhe detajimin e rasteve në përputhje me Udhëzimin 19/2019 "Për Mbikëqyrjen e Organizatave Jofitimprurëse në Funkcion të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit" dhe e përditësojnë atë.

5 Publikojnë raporte vjetore mbi problematikat e konstatuara të OJF-të dhe japin statistika të përgjithshme mbi rastet e trajtuara, masat e marra, gjetjet, etj.



Kjo fletëpalosje u përgatit në kuadër të projektit “Parandalimi i kufizimeve për organizatat e shoqërisë civile në emër të parandalimit të pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit në Shqipëri”, i cili financohet nga Projekti Global i GlZ ‘Lufta kundër qarkullimit të paligjshëm të fondeve’.

Për më shumë information kontaktoni:

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Rruga e Elbasanit, Ndërtesa Park Gate, kati 10-të, Tiranë, Shqipëri



www.partnersalbania.org



partners@partnersalbania.org